

Prishtinë 30/06/2005

Në përputhje me kompetencat e dhëna në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, nxjerr si vijon:

Udhëzim i Përkohshëm I_01_2005 për Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore

Kapitulli 1

Procedurat për Raportimin Rregullativ në Ngrohjen Qendrore dhe Përmbajtja e të Dhënave Financiare dhe Teknike

Neni 1

Raportimi Rregullativ në sektorin e ngrohjes qendrore do të bëhet për aktivitetet e prodhimit, distribuimit dhe furnizimit me ngrohje.

Neni 2

Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore do të kryejnë raportim rregullativ siç vijon:

2.1 Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore janë të obliguara të paraqesin në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë raporte financiare, duke përfshirë anekset, në përputhje me Standardet e Kontabilitetit të Kosovës dhe Rregulloren 2003 / 30 mbi Regjimin e Raportimit Financiar të Bizneseve, si dhe Raportin(et) e Auditorit për vitin e kaluar kalendarik, siç vijon:

- a) Bilancin e Gjendjes – afatin përfundimtar për paraqitje 28 shkurt
- b) Pasqyren e të Ardhurave dhe Shpenzimeve – afatin përfundimtar për paraqitje 28 shkurt
- c) Raportin e Pavarur të Auditorit – afatin përfundimtar për paraqitje 31 mars
- d) Raportin Financiar Gjashtë-mujor – afatin përfundimtar për paraqitje 15 korrik.

2.2 Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore janë të detyruara që deri më 31 korrik, të paraqesin në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë këto raporte rregullative:

- a) Raportin e Aseteve Operative
- b) Raportin e Shpenzimeve dhe të Ardhurave Vjetore
- c) Raportin e faturimit dhe arkëtimit të pagesave
- d) Raportin e Shpenzimeve Investuese
- e) Raportin Teknik
- f) Raportet Mbështetëse

Neni 3

- 3.1 Në Shtojce Nr.1 janë dhënë raportet rregullative siq janë përcaktuar në Nenin 2.2 dhe Nenin 6
- 3.2 Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore do të paraqesin në Zyren e Rregulatorit të Energjisë deklaratat sipas Neneve 2.1 dhe 2.2, çdo vit kalendarik brenda afateve përfundimtare të përcaktuara në programin raportues në Shtojcën Nr.2.

Kapitulli 2 **Udhëzime për Plotësimin e Deklaratave Rregullatore**

Neni 4

Udhëzimet për plotësimin e Raporteve Rregullative, japin metodat e regjistrimit të të dhënave dhe përgatitjen e raporteve të kërkuara nga ZRrE-ja prej Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore. Gjatë përgatitjes së raporteve rregullative, Ndërmarrjet e Ngrohjes Qendrore duhet të i përbahen këtyre udhëzimeve

Neni 5

Raportet Rregullative përgatiten për aktivitetet vijuese të ngrohjes qendrore të ndarë në grupe:

- a) G1 - Prodhimi i ngrohjes
- b) G2 – Distribuími dhe furnizimi me ngrohje

Neni 6

Deklaratat Rregullatore strukturohen në grupet vijuese:

- a) Raporti i Aseteve Operative
- b) Raporti i Shpenzimeve dhe të Ardhurave Vjetore
- c) Raporti i faturimit dhe arkëtimit të pagesave
- d) Raporti i Shpenzimeve Investuese
- e) Raporti Teknik
- f) Raportet Mbështetëse

Neni 7

Udhëzime për Plotësimin e Raportit të Aseteve Operative – Raporti A-G1, G2

- 7.1 Raporti i Aseteve Operative përfshin asetet që përdoren për të kryer një aktivitet të caktuar të ngrohjes qendrore, pra asetet fikse, dhe asetet jo të prekshme (patenta, etj), dhe ndahen në kategoritë e mëposhtme:
 - a) Asetet Drejtpërdrejt të Përcaktuara (Angazhuara) – të cilat marrin pjesë drejtpërdrejtë në kryerjen e aktiviteteve të veçanta të ngrohjes qendrore (G1 ose G2), dhe qartë mund të përcaktohen si asete të një aktiviteti të caktuar ngrohjes qendrore.

- b) Asetet Mbështetëse – asetet që shërbejnë për të kryer më shumë se një aktivitet, dhe që nuk mund të përcaktohen qartë si asete të një aktiviteti të ngrohjes qendrore.
- c) Asete të Përbashkëta – asetet që shërbejnë për të kryer aktivitete të ngrohjes qendrore (grupet G1 dhe G2), si dhe aktivitete të tjera jo të lidhura me ngrohjen qendrore.

7.2 Asetet operative nuk përfshijnë:

- a) Projekte investimi jo të prekshme në vijim,
- b) Paradhëniet e paguara për asetet afatgjata jo të prekshme
- c) Projekte investimi të prekshme në vijim,
- d) Paradhënie të paguara ndaj aseve të prekshme afatgjata
- e) Rregullimi i çmimit të blerjes së aseteve,
- f) Investimin financiar, dhe
- g) Vlerën e sendeve të blera në lizing (qeranë) financiare, që nuk është mbajtur në llogaritë kontabël.

7.3 Asetet operative deklarohen sipas vlerave vijuese:

- a) Çmimin e blerjes me koston historike,
- b) Zhvlerësimi i akumuluar,
- c) Vlera sipas librave kontabël, dhe
- d) Koston (Çmimin) zëvendësuese në vlerën e tregut

7.4 Shpjegim i detajuar i përmbajtjes së Raportit të Aseteve Operative për çdo aktivitet të ngrohjes qendrore

a) Asetet Drejtëpërdrejt të Përcaktuara (Angazhuara)

a.1) Prodhimi i ngrohjes

- Kufizimi:
 - Fillimi: sistemet e përdorur për pranimin e karburantit
 - Fundi: pika e dërgimit të ngrohjes në rrjetin e distribuimit të ngrohjes.
- Artikujt kryesorë për t'u përfshirë:
 - Kaldajat (kaldajat me mazut ose me dizel)
 - Oxhaku,
 - Shkëmbyesit të nxehtësisë në ngrohtore,
 - Pompa qarkulluese në ngrohtore,
 - Sisteme për trajtimin e karburantit,
 - Sisteme të menaxhimit të ujit, përfshirë trajtimin kimik të ujit,
 - Sisteme ambientale për kaldajat,
 - Sisteme për prodhimin e elektricitetit për konsum të brendshëm në ngrohtore (p.sh. gjeneratorët e energjisë elektrike).

a.2) Distribuimi dhe Furnizimi me ngrohe

- Kufizimi:
 - Fillimi: pika e kalimit të ujit të ngrohët prej ngrohtores në sistemin e distribuimit të ngrohjes,

- Fundi: pika e kalimit të ujit të ngrohët në sistemin e konsumatorit ose pika matëse.
- Artikujt kryesorë për t'u përfshirë:
 - Tubacionet e ujit të ngrohët,
 - Rrjeti i distribuimit,
 - Tubacionet kryesore të furnizimit (tubacionet në rrjetin primarë),
 - Stacionet transferuese – Nënstacionet,
 - Sistemet matëse dhe kontrolluese.

a) Asetet Mbështetëse

Asetet mbështetëse janë asetet e përdorura për prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin e ngrohjes.

- Artikujt kryesorë që do përfshihen nën pasurinë mbështetëse:
 - Ndërtesa dhe struktura inxhinierike (si p.sh. njësitë prodhuese),
 - Softverë,
 - Hardverë,
 - Sisteme të informacionit gjeografik,
 - Pajisje, inventari,
 - Studime, projekte, shërbime ligjore dhe këshilluese

b) Asetet e Përbashkëta

Asetet e përbashkëta përbëhen nga prona që përdoren për të kryer aktivitete të lidhura me ngrohjen qendrore dhe për kryerjen e aktiviteteve të tjera jo të lidhura me ngrohjen qendrore.

Artikujt kryesorë:

- Artikujt kryesorë
 - Toka,
 - Ndërtesat e përbashkëta për zyra,
 - Garazhe,
 - Sisteme të informimit të kompanisë,
 - Artikuj të tjerë pronësorë.

Neni 8

Udhëzime për plotësimin e Raportit të Shpenzimeve dhe të Ardhurave Vjetore – Raporti B-G1,G2

- 8.1 Raporti i Shpenzimeve dhe të Ardhurave Vjetore përbëhet nga të ardhurat dhe shpenzimet e lejueshme, të strukturuar sipas pozicioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore, si dhe sipas llojit të aktiviteteve të ngrohjes qendrore (grupet G1, G2)
- 8.2 Shpenzimet e lejueshme nënkupton shpenzimet e nevojshme për të kryer aktivitetin e ngrohjes qendrore dhe përfshijnë:
 - a) Shpenzimet e burimeve primare të energjisë (karburantet),
 - b) Shpenzimet e energjisë së konsumuar (elektricitet, ujë),

- c) Shpenzimet e personelit – pagat plus kontributet e pensionit dhe taksa të tjera të pagueshme prej kompanisë,
- d) Shpenzimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e sistemit,
- e) Zhvlerësimin e regjistruar të aseteve fikse,
- f) Interesi nga huatë e marra dhe tarifatat e bankës si dhe shpenzime të tjera,
- g) Shpenzimet të tjera që mund të jenë të lidhura direkt me aktivitetin e ngrohjes qendrore, si blerja e shërbimeve të ndryshme të jashtme nga kontraktues të jashtëm, etj., dhe
- h) Shpenzime të justifikuara financiare dhe të jashtëzakonshme.

8.3 Kostot e lejueshme nuk përfshijnë:

- a) Subvencionet,
- b) Shpenzimet e refuzuara prej autoriteteve tatimore,
- c) Marzhat nga qeraja (lizingu),
- d) Shpenzimet për rezervat të lëna mënjanë dhe të liruara,
- e) Pagesat e qerasë për vlerën e artikujve që nuk janë regjistruar në llogaritë kontabël, dhe
- f) Shpenzime të tjera financiare dhe të jashtëzakonshme.

8.4 Struktura themelore e ndarjes së shpenzimeve përbëhet nga:

- a) Shpenzimet operative
 - Pjesa e ndryshueshme (variable)
 - Pjesa e pandryshueshme (fikse)
 - Zhvlerësimi i aseteve fikse

8.5 Ndarja e shpenzimeve sipas nivelit të pjesëmarrjes në kryerjen e aktiviteteve specifike të ngrohjes qendrore:

- a) Shpenzimet Drejtpërdrejt të Përcaktuara – të cilat shkaktohen drejtpërdrejt për kryerjen e një aktiviteti specifik të ngrohjes qendrore (G1 ose G2), dhe mund të përcaktohen qartë shpenzim për një aktiviteti të caktuar të NQ
- b) Shpenzime Mbështetëse – të cilat shkaktohen për të kryer më shumë se një aktivitet të ngrohjes qendrore dhe janë të lidhura me menaxhimin e drejtpërdrejtë të prodhimit të ngrohjes, distribuimit dhe furnizimit me ngrohje; këto shpenzime nuk mund t'i caktohen vetëm një aktiviteti të veçantë të ngrohjes qendrore.
- c) Shpenzime të Përbashkëta – këto përfaqësojnë shpenzimet e përbashkëta të lidhura me administrimin dhe menaxhimin e biznesit të kompanisë në tërësi; këto kosto përftohen për kryerjen e aktiviteteve të ngrohjes qendrore dhe aktiviteteve që nuk kanë të bëjnë me ngrohjen qendrore.

8.6 Të ardhurat e lejueshme përfshijnë: shitjet për aktivitetet e caktuara të ngrohjes qendrore, p.sh. shitjet e ngrohjes dhe shërbimet e bëra, si dhe të ardhura të tjera që rrjedhin nga një aktivitet i caktuar.

8.7 Të ardhurat e lejueshme nuk përfshijnë të ardhurat nga aktivitete që nuk kanë të bëjnë me ngrohjes qendrore, të ardhurat nga shitja e aseteve të prekshme dhe jo të prekshme dhe inventarit, si dhe të ardhura nga dhënja me qera e pronës.

Neni 9

Në raportin e faturimit dhe arkëtimit të pagesave – Raporti C-G2, janë dhënë të dhënat për faturimin dhe arkëtimin e pagesave për ngrohjen e furnizuar konsumatorëve në sezonin e caktuar të ngrohjes.

Neni 10

Udhëzime për plotësimin e Raportit së Shpenzimeve të Investimit – Raporti D-G1,G2

- 10.1 Në këtë raport futen shpenzimet për investimet aktuale dhe të planifikuara të ndërmarrjes së ngrohjes qendrore për vitin aktual dhe për katër (4) vitet e ardhshëm.
- 10.2 Raporti përbëhet nga investimi i bërë direkt në aktivitetin e ngrohjes qendrore - prodhimin, distribuimin dhe furnizimin e ngrohjes.
- 10.3 Gjithashtu, në pozicionin “të tjera”, raporti përmban shpenzime investimi që i përkasin pronës mbështetëse dhe të përbashkët, si dhe aktiviteteve që nuk i takojnë ngrohjes qendrore; paraqitje e detajuar e këtij pozicioni duhet të jepet si informacion plotësues i raportit.
- 10.4 Shpenzimet e Investimit përmbajnë, mes të tjerash, edhe shpenzimet për paradhënie dhe/ose për ndërtimin në vijim. Në anën tjetër, nuk përfshihen shpenzimet për investime financiare.

Neni 11

Udhëzime për plotësimin e Raportit Teknik - Raporti E-G1,G2

- 11.1 Ky raport përmban pjesët vijuese: Të Dhënat Teknike të Përgjithshme; Bilanci Energjisë (Prodhimit të Ngrhjes); Bilanci i Ngrhjes (Furnizimit); dhe Konsumi i Karburanteve.
- 11.2 Të Dhënat Teknike të Përgjithshme përmbajnë si vijon:
 - a) Kapaciteti i instaluar i ngrohjes – d.m.th. kapacitetin e plotë të ngrohjes së instaluar në ngrohore, pavarësisht prej gjendjes aktuale teknike,
 - b) Kapaciteti i disponueshëm i ngrohjes – kapaciteti i plotë i ngrohjes në gjendje pune (i gatshëm për operim),
 - c) Gjatësia e rrjetit të distribuimit – gjatësia e rrjetit primar (tubacioni)
 - d) Numri i nënstacioneve – numri total i nënstacioneve të instaluar në sistemin e ngrohjes qendrore / distribuimit, dhe
 - e) Numri i nënstacioneve aktive – numri total i nënstacioneve përmes të cilëve aktualisht furnizohen konsumatorët.
- 11.3 Bilanci i Energjisë (Prodhimit të Ngrhjes) përbëhet nga:
 - a) Energjisë së futur nga karburanti – d.m.th. energjia totale e karburantit në MWh e përdorur për prodhimin e ngrohjes
 - b) Prodhimi bruto i ngrohjes – ngrohja totale e prodhuar prej njësive prodhuese
 - c) Prodhimi neto i ngrohjes – sasia e ngrohjes e dërguar në rrjetin e distribuimit, e matur në pikën e ndarjes midis prodhimit të ngrohjes dhe rrjetit të distribuimit.

- d) Konsumimi vetanak – sasia e ngrohjes së përdorur për konsumim vetanak në ngrohore, si p.sh. ngrohja për sistemet ndihmëse, ngrohja e hapësirave të godinave, etj.
- e) Efikasiteti total i ngrohtores – si raport midis prodhimit neto të ngrohjes dhe futjes së karburantit; **Formula: Efikasiteti i ngrohtores = (Prodhimin neto të ngrohjes / Energjinë e futur nga karburanti) * 100**
- f) Konsumi i ujit – sasia totale e ujit të thjeshtë i përdorur për përgatitjen e ujit të trajtuar (ujë i trajtuar për (ri) mbushjen e sistemit),
- g) Konsumi i elektriciteti– elektriciteti i konsumuar në ngrohore dhe në rrjetin e distribuimit, si p.sh. elektriciteti për parangrohjen e mazutit, për kaldajën, për vënien në punë të pompave kryesore qarkulluese për rrjetin primarë, etj.

11.4 Bilanc i Ngrhjes (Furnizimit) përbëhet nga:

- a) Sasia e ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit – sasia e ngrohjes së matur në pikën ndarëse midis prodhimit të ngrohjes dhe rrjetit të distribuimit; korrespondon me prodhimin neto të ngrohjes
- b) Furnizimi i konsumatorëve me ngrohje – sasia e ngrohjes e dërguar në nënstacionet e konsumatorëve, e matur në pikën matëse, pikën ndarëse midis rrjetit primarë dhe sekundarë
- c) Humbjet në distribuim [MWh] – diferenca midis sasisë së ngrohjes e futur në rrjetin e distribuimit dhe ngrohjes së furnizuar konsumatorëve; **Formula: Humbjet në distribuim = Hyrje e ngrohjes – Furnizim i ngrohjes**
- d) Humbjet në shpërndarje [%] – **Formula: Humbjet në shpërndarje = [(Ngrhja e futur në rrjetin e distribuimit – Furnizim i ngrohjes) / Ngrhja e futur në rrjetin e distribuimit] * 100**

11.5 Të dhënat e konsumatorëve përbëhen nga si vijon:

- a) Kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes – shuma e kapacitetit të dakorduar për çdo nënstacion konsumatorësh (e përcaktuar si kërkesë për ngarkesë maksimale për temperaturën e jashtme të dizajnuar),
- b) Hapësira totale e ngrohur – hapësira totale e ngrohur e furnizuar me ngrohje për çdo grup konsumatorësh (aktualisht: shtëpiakë, komercialë dhe institucionalë)
- c) Kërkesa specifike për kapacitet të ngrohjes –kërkesa e vlerësuar (llogaritur) e kapacitetit të ngrohjes për metër katror (përcaktuar si kërkesë për ngarkesë maksimale për metër katror për temperaturën e jashtme të dizajnuar) për çdo grup konsumatorësh (aktualisht: shtëpiakë, komercialë dhe institucionalë)
- d) Orët nominale të ngarkesës së plotë – e përllogaritur si raporti midis ngrohjes vjetore të furnizuar tek konsumatorët dhe kapaciteti i kontraktuar i ngrohjes për çdo grup konsumatorësh,
- e) Kërkesa për ngrohje – kërkesa e përllogaritur për ngrohje për çdo grup konsumatorësh; **Formula: Kërkesa për ngrohje = Kërkesa specifike për kapacitet të ngrohjes * Hapësira totale e ngrohur * Orët nominale të ngarkesës së plotë**

11.6 Konsumimi i karburanteve është si vijon:

- a) Sasia e karburantit të konsumuar në tonë
- b) Vlera e Ulët e Ngrhjes – sasia e ngrohjes së dobishme e fituar prej djegies së një toni karburant

- c) Energjia nga karburant – **Formula: Energjia në karburant = Sasia e karburantit * Vlera e Ulët e Ngrohjes**

Neni 12

Raportet Mbështetëse duhet të përmbajnë:

- a) Raporte ditore dhe mujore të prodhimit të ngrohjes,
- b) Raporte mujore mbi regjistrimin dhe analizat e furnizimit të matur të ngrohjes nëpër nënstacione,
- c) Bazën e të dhënave të konsumatorëve të azhuruar, dhe
- d) Çdo dokument tjetër të bashkangjitur që nevojitet për të mbështetur dhe sqaruar deklaratat rregullative të paraqitura

Neni 13

Ky Udhëzim do të jetë i aplikueshëm menjëherë pasi të nënshkruhet

Për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRë)

Dr. Nick F. Frydas
Kryesues i Bordit